



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1631 Prot.

Pogradec, më 18.04. 2025

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim paraprak.

Znj.MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Znj. Kryetare ,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues,

PËR

“MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË
PROJEKTIT ME TITULL “SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES
PËR MBIKËQYRJEN HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË.” NË
KUADËR TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA
CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”

Me respekt,

KRYETAR

Ilir Xhakolli





Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit : 2

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 3

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin : 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____. _____. 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë _____. _____. 2025

PËR

**“MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME
TITULL “SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN
HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË.” NË KUADËR TË PROGRAMIT
NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-
2027”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull **“SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË”**, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1.Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit me titull “SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË” të financuar nga Programi Ndërkufitar Greqi - Shqipëri 2021-2027

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

2. Bashkia Pogradec, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, në rastin e miratimit të projektit nga vlerësuesit e Delegacioni Evropian, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.



3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia e Integritetit Evropian dhe administrata e Bashkisë Pogradec të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

K R Y E T A R

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Nr. 1631 Prot.

Pogradec, më 18.04. 2025

RELACION

E nderuar Kryetare, të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ", të Ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "*Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore*" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull "**SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË**", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit INTERREG (VI-A) IPA CBC "GREQI-SHQIPËRI 2021-2027" me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec:

Ju paraqesim për miratim paraprak në rast fitimi të projektit me titull "**SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO METEOROLOGJIKE TOKË -UJË**"

Ky projekt është në kuadër të granteve të thirrjes së parë për propozime të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg (VI-A) IPA CBC "Greqi-Shqipëri 2021-2027"

Partner në këtë projekt janë:

1. Bashkia Kozan lider projekti. Greqi
2. Bashkia e Korfuzit partner Greqi
3. Observatorit Kombëtar i Kërkimeve të Athinës partner Greqi
4. Bashkia Gjirokastrë partner Shqipëri.
5. Bashkia Pogradec partner Shqipëri.



Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe greke është: 1.084.415 euro.

Buxheti për Bashkinë Pogradec është 149,940 euro

Bazuar në këtë buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit në vlerën 29.988 euro dhe TVSH-së.

Thirrja në të cilën bazohet shkrimi i këtij projekti lidhet me marrjen e masave ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve të lidhura me klimën, përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut, mbrojtjen civile dhe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive. Në këtë kontekst projekti financon blerjen e një paisjeje të paisur me një sistem të integruar informacioni, për monitorimin, mbikëqyrjen hidro-meteorologjike të tokës dhe parashikimin afatshkurtër të rreziqeve mjedisore. Nëpërmjet vendosjes së një sistemi iSAFE, i cili është i pajisur me sensorë në distancë do mund të realizohen matje brenda një rajoni prej disa dhjetëra kilometrash ku do mund të monitorohen:

- stuhitë, duke përfshirë shiun, breshrin dhe borën
- parashikim për përmbytjet e menjëhershme dhe rrëshqitjet e tokës
- sistemi i paralajmërimit të hershëm për autoritetet e mbrojtjes civile

Kështu, qëllimi kryesor i projektit me zhvillimin dhe vendosjen e një rrjeti të tillë në rajonet e aplikimit të projektit, është përcaktimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimi i njohurive për të mbështetur sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimin e rrezikut për të ofruar të gjitha sa më sipër.

Sistemet e paralajmërimit të hershëm të rrezikut janë me përfitim sepse mund të shpëtojnë jetë dhe prona. Ky sistem do vendoset në Bashkinë e Gjirokastrës dhe do mbulojë gjithë partnerët e projektit. Për Bashkinë e Pogradecit, nga buxheti i projektit është menduar blerja e një kamioni transportues. Nga konsultimet me strukturat brenda Bashkisë, kjo ide ka qenë një nevojë e evidentuar dhe prezantuar nga Ndërrmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike. Kjo makineri do mundësojë transportimin e materialeve në rast dëmtimi në infrastrukturë, transportim të sedimenteve nga përrrenjtë, lumenjtë, etj. Gjithashtu, do ndihmojë në procesin e punës për transportim të algave të nxjerra nga liqeni.

Njësia e Integrimit Evropian, me qëllim përmbushjen me sukses të objektivave të procesit të integrimit evropian, ku kusht është dhe zbatimi me rigorozitet i projekteve IPA. Ndërkufitare duke kaluar të gjitha hallkat ligjore që nga miratimi në Këshillin Bashkiak deri tek kontrolli dhe çertifikimi i shpenzimeve, kërkon vlerësimin e impaktit të këtij projekti nga Këshilli Bashkiak, miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit dhe mbështetjen për të çuar para këtë projekt.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Ju faleminderit!

Konceptoi: E. MULLISTI

Pranoi: B. ÇOMO

Miratoi: P. ZIKO

Konfirmoi: D. BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 1631/Prot
14

Pogradec, më 18.04.2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

“MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME
TITULL “SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN
HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË.” NË KUADËR TË PROGRAMIT
NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”,

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.



Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: “**Akt normativ nënligjor**” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.


Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në Bashkinë e Pogradeci i cili synon të zhvillimin dhe vendosjen e një rrjeti të tillë në rajonet e aplikimit të projektit, është përcaktimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimi i njohurive për të mbështetur sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimin e rrezikut, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantaresimit INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027.


Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.


Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI







REPUBLIC OF
SECRET
ARMY CO

